

# THEMELIMI I KËSHILLIT TË NXËNËSVE NË Sh.M.U.





KYC

Rr. Kroi i Bardhë, nr.81, Dardani

Prishtinë 10000, Kosovë

kyckosova@gmail.com

+383 (44) 96 45 75



Të drejtat e autorit © 2022. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

# Hyrja

Ky manual përcakton procedurat e themelimit, rolin, detyrat dhe funksionalizimin e Këshillit të Nxënësve (KN) në arsimin e mesëm të ulët në Republikën e Kosovës në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2020 për Themelimin dhe Funksionalizimin e Këshillit të Nxënësve.

## Përkufizime

Shkurtesat e përdorura në këtë Manual kanë këto kuptime:

- **KN**- Këshilli i Nxënësve;
- **KDSH**- Këshilli Drejtues i Shkollës
- **MASHTI**- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- **DKA**- Drejtoria Komunale e Arsimit.

## Themelimi i Këshillit të Nxënësve

Këshilli Drejtues i Shkollës (KDSH) themelon Këshillin e nxënësve (KN) në nivel shkolle. Themelimi i KN, mund të iniciohet nga KDSH, drejtori i shkollës apo nga vet nxënësit. Nxënësit e shkollës themelojnë KN, të mbështetur dhe përcjellë nga mësimdhënësit dhe stafi tjetër profesional.



# Roli dhe detyrat e Këshillit të Nxënësve

- Përfaqëson zërin e të gjithë nxënësve në strukturat e tjera të shkollës dhe jashtë saj, për plotësimin e interesave të komunitetit të nxënësve për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe për një arsimim sa më cilësor.
- Përfaqëson pikëpamjet e nxënësve dhe promovon frymën demokratike brenda shkollës.
- Merr pjesë në grupet punuese për hartimin e Planit Zhvillimor të Shkollës si dhe në hartimin e politikave shkollore të cilat duhet miratuar edhe nga KDSH.
- Përfaqëson interesat e nxënësve të KDSH dhe menaxhmentit të shkollës.
- Shërben si mekanizmi kryesor i komunikimit mes shkollës dhe nxënësve dhe mbron interesin për mirëqenien e nxënësve.
- Orienton dhe këshillon nxënësit e ri në shkollë.
- Merr rol aktiv në ngjarjet kulturore dhe organizon aktivitete jashtëkurrikulare.
- Merr rol aktiv në inicimin e themelimit dhe në përfaqësimin e klubeve, garave dhe aktiviteteve tjera me interes për nxënësit dhe shkollën.

- Ndërvepron në interesin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Shërben si mbikëqyrës që përfaqësimi gjinor, etnik dhe i grupeve të cenueshme të respektohen.
- Punon dhe angazhohet në përmirësimin e mjedisit mësimor dhe kushteve të punës, përfshirë interesat për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e tyre.
- Anëtarët obligohen të ndajnë vendimet dhe njoftimet me nxënësit e klasave të veta.



# Struktura e Këshillit të Nxënësve

- KN përbëhet nga një kryetar/e i/e secilës klasë të shkollës.
- Të drejtë vote për vendimet e KN kanë kryetarët/et e klasave si anëtar të KN.
- Anëtarët e KN, përmes votës së fshehtë zgjedhin kryesinë e Këshillit të Nxënësve të shkollës.
- Kryesinë e KN, në shkollat e mesme të ulëta, e përbëjnë shtatë (7) anëtarë, të cilët zgjidhen nga anëtarët e KN, si përfaqësues të nxënësve.
- Kryetari/ja dhe nënkryetarët e shkollës zgjidhen me anë të votave nga përfaqësuesit e secilës klasë në shkollë dhe bëhen pjesë e kryesisë së KNSH.
- Në shkollat e mesme të ulëta nxënësi/ja, më i/e votuar, merr pozitën e kryetarit/es së shkollës dhe dy (2) nxënësit e dytë më të votuar, marrin pozitën e nënkryetarëve të shkollës.
- Përfaqësuesit e klasave të një paraleleje (gjenerate), zgjedhin një (1) përfaqësues të paraleles, pas zgjedhjes së pozitave të kryetarit dhe nënkryetarit të KN.
- Përfaqësuesit e zgjedhur të secilës paralele, në mënyrë direkte janë pjesë e kryesisë së KN.

- Të përzgjedhurit për pozitën e kryetarit dhe nënkryetarit, obligohen të dorëhiqen nga pozitat e përfaqësuesve të klasave dhe paraleleve.
- Në shkollat që ka nxënës nga grupet e cënueshme, një nxënës përfaqëson dhe mbron interesat e grupeve të cënueshme, pa të drejtë vote, në kryesinë KN.
- Kryesia e KN, zgjedh nga anëtarët e vet një arkëtar dhe sekretar.
- Kryesia e KN mund t'ju përcaktojë anëtarëve të tjerë pozita dhe përgjegjësi, varësisht nevojave të kryesisë.
- Kryesia e KN së bashku me anëtarët krijojnë planin vjetor të punës.
- Kryesia takohet së paku 6 herë në vit.
- Kryesia sipas nevojës në takime fton si këshillëdhënës, mësimdhënës, drejtorin, përfaqësues të prindërve apo ekspert tjerë.
- Kryesia e KN ka të drejtë që të themelojë grupe punuese për nevojat e nxënësve të shkollës të cilat propozohen dhe votohen në takimet e KN.
- Vendimet e kryesisë së KN, merren me anë të votimit të hapur dhe vlen parimi i shumicës së thjeshtë (50+1) nga anëtarët me të drejtë vote.

- Nëse ndonjëri/a nga anëtarët e KN nuk është aktiv, mungon në takimet dhe aktivitetet e KN, apo shkel rregullat dhe politikat e shkollës, largohet nga kryesia dhe zëvendësohet me një nxënës tjetër, i cili zgjidhet si përfaqësues i klasës së vet.

## Zgjedhjet dhe mandati i anëtarëve

- Themelimi i KN duhet të filloj në muajin e parë të çdo viti të ri shkollor. KN duhet të jetë i konsoliduar më së largu deri në fund të muajit të parë të fillimit të vitit shkollor.
- Zgjedhjet e KN në nivel klase dhe shkolle duhet të bëhen në mënyrë demokratike dhe me anë të votës së fshehtë.
- E drejta për të zgjedh dhe për tu zgjedhur duhet t'i takoj secilit nxënës/e të shkollës pa dallim, moshe, gjinie, race, etnie, feje, orientimi seksual apo nevojave të veçanta, dhe jo domosdoshmërisht me sukses të shkëlqyeshëm si dhe jo me notë së sjelljes të thyer.
- Vendimet për zgjedhjet e themelimit të KN të shkollës dhe klasës, merren me anë të votimit të hapur dhe vlen parimi i shumicës së thjeshtë (50+1) nga anëtarët me të drejtë vote.
- Anëtarë/e me të drejtë vote në nivel klase janë të gjithë nxënësit/et e asaj klase, ndërsa në KN të drejtë vote kanë vetëm nxënësit/et e zgjedhur përfaqësues të klasës së tyre përkatëse.



- Nxënësit kanë të drejtë të kërkojnë nga KDSH që të delegojë përfaqësues të cilët monitorojnë zgjedhjet e KN, pa të drejtë vote.
- Kandidatët/et për pozita udhëheqëse në KN, duhet të prezentojnë planin e tyre të punës para anëtarëve të KN.
- Mandati i anëtarëve të zgjedhur të KN në nivel klase dhe shkolle është njëvjeçar, me mundësi rizgjedhje vetëm edhe për një mandat tjetër.
- Mandati i anëtarëve të Këshillit të Nxënësve pushon në rast se anëtarët/et kanë përfunduar shkollimin në shkollën të cilën e përfaqësojnë.



# Përfaqësimi në KDSH dhe vendimmarrja

- Kryetari/ja i/e KN të shkollës, merr pjesë në takimet e KDSH, si anëtarë me të drejtë vote.
- Kryetari/ja i/e KN përfaqëson mendimin dhe të drejtën e të gjithë nxënësve të shkollës në KDSH.
- Nëse shkolla ka më shumë se 1000 nxënës, atëherë KN ka të drejtën të përfaqësohet me dy anëtarë me të drejtë vote në takimet e KDSH.
- Përfaqësuesit e nxënësve në KDSH nuk marrin pjesë në takimet e KDSH në raste kur diskutohet për çështje personale të personelit të shkollës, apo çështje tjera të ndjeshme. Sipas kufizimeve të përcaktuara në ligjin për arsimin parauniversitar.



# Buxheti dhe raportimi

- KN me aprovimin e KDSH kanë të drejtë që përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në aktivitete jashtëkurrikulare, aplikimeve për projekte, donacion.
- Buxheti i KN duhet të përdoret vetëm për organizimin e aktiviteteve, duke u bazuar në qëllimin e përcaktuar me këtë Udhëzim administrativ dhe për përmbushjen e planit të punës.
- Përgjegjës për menaxhimin e buxhetit të KN është arkëtari i KN dhe anëtarët tjerë të kryesisë.
- Kryesia e KN në nivel shkolle dërgon një raport financiar (nëse ka pasur qarkullim të të hollave, gjatë vitit) dhe narrativ të aktiviteteve të mbajtura tek KDSH dhe një kopje i dërgohet drejtorisë së shkollës dhe KN.
- Kryesia e KN, informon drejtorin e shkollës, KDSH dhe KN, me shkrim për të gjitha vendimet e marra në lidhje me buxhetin dhe shpenzimet.






# Kërkesat dhe ankesat

- Nxënësit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesa, kërkesa dhe reagime në kryesinë e KN në lidhje me kompetencat e KN dhe për çështje tjera.
- KN promovon të drejtën e nxënësve për ankesa dhe kërkesa brenda procedurave të rregullta të ankimit.
- Kryesia e KN, duhet të shqyrtojë dhe të kthejë përgjigje tek nxënësit për ankesat, kërkesat dhe reagimet e parashtruara në lidhje me kompetencat KN, në një afat kohor, më së largu 7 ditë pune.
- Ankesa, kërkesat dhe reagimet e nxënësve që adresohet te KN, duhet të regjistrohen si evidencë për raportim tek KDSH.
- Kërkesat, ankesat dhe reagimet e KN të shkollës të cilat dalin jashtë kompetencave të KN, bëhen me shkrim apo me postë elektronike dhe protokollohen nga administrata e shkollës.
- Kryesia e KN të shkollës, shqyrton ankesat, kërkesat dhe reagimet e nxënësve të cilat dalin jashtë kompetencave të tyre dhe i adreson ato, tek menaxhmenti i shkollës.
- Menaxhmenti i shkollës u përgjigjet kërkesave, ankesave dhe reagimeve të KN me shkrim brenda 7 ditëve të punës.
- KN, ka të drejtë të vazhdojë ankesat në DKA, në rast të pakënaqësisë me reagimin nga menaxhmenti i shkollës.



## PYETJE OSE KOMENTE

 +383 44 964 575

 [kyckosova@gmail.com](mailto:kyckosova@gmail.com) | [knkkosova@gmail.com](mailto:knkkosova@gmail.com)

## RRJETET SOCIALE

 [@kyckosova](#) | [@knkkosova](#)

 [kyckosova](#) | [knkkosova](#)



